



Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, kordinon dhurimin e 20,000 maskave textile, të dhuruara nga Marlotex sh.p.k.

Në kushtet e Pandemisë COVID-19, parashikimet e ekspertëve identifikojnë përhapjen më të gjerë të virusit COVID-19, në periudhën në vijim, për shkak të sezonit, mbivendosjes së virozave të tjera stinore si dhe grupimeve të mëdha nëpër shkolla e universitete.

Transmetimi i lartë i këtij virusi përmes personave asimptomatik, kërkon ndërgjegjësim e vëmendje të lartë ndaj higjenes personale apo distancimit social, nga secili prej nesh, po aq sa dhe të të gjithë institucioneve, organizatave private e publike, për të minimizuar sado pak shpërndarjen e këtij virusi, si dhe ri-infektimin e popullatës.

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare i drejtohet të gjithë bizneseve partnere dhe jo vetëm, të ofrojnë mbështetjen e tyre, duke i u bashkuar nismës së konfirmuar tashmë, për shpërndarjen e maskave mbrojtëse për të gjithë nxënësit e shkollave në Shqipëri.

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, do të organizojë shpërndarjen e 20,000 maskave textile gjatë muajve shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2020, të dhuruara nga kompania **Marlotex sh.p.k.**, me qendër në Berat, në vijimësi të dhurimeve të herë pas herëshme që **Marlotex** ka kryer.

Logjistika e shpërndarjes së maskave textile, të dhuruara nga sipërmarrësi Gasmen Toska, do të kordinohet në bashkëpunim me organizatën jo-fitimprurëse World Vision, e cila adreson shkolla të grupeve shoqërore në nevojë.

Sipërmarrësi Gasmen Toska, nëpërmjet **Marlotex** ofron një mbështetje shumë të madhe në parandalimin e mëtejshëm të virusit COVID-19, duke qenë se maskat janë identifikuar si një barrier e rëndësishme për shpërndarjen e COVID-19.

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, nxit të gjithë bizneset partnere apo biznese të tjera, jo anëtare, që në këtë inisiativë të përfshihen duke bërë paketën e dhurimit më të gjerë.

Nevoja të tjera të sugjeruara:

- ◆ Liquid sanitar për duart, apo pastrimin e sipërfaqeve;
- ◆ Desinfektues (xhel & alkool)
- ◆ Doreza
- ◆ Pajisjes shkollore për grupet në nevojë.

Të gjithë kemi nevojë për njëri-tjetrin dhe çdo kontribut mbi kujdesin e higjenes personale, do të jetë shumë i rëndësishëm për fëmijëve tanë, apo akoma më mirë të shërbejë në shkëputjen e zinxhirit COVID-19.